



**AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA FIER**

Nr. *813/p* Prot.

Datë: 19/04/2016

KONTRATE SHITESH
E KONTRATES SE SIPERMARRJES DATE 19.01.2015 ME OBJEKT:

**“RIKONSTRUKSION I RRUGES LIDHESE MIDIS NJE GRUPI FSHATRASH
MBYET, PLYK, KRAPS, LALAR”.**

PALËT:

- ❖ INVESTITORI : BASHKIA FIER
- ❖ SIPERMARRRES : “ALB-STAR” sh.p.k. FIER



AS

KONTRATE SHTESE

E KONTRATES SE SIPERMARRJES 19.01.2015

“RIKONSTRUKSION I RRUGES LIDHESE MIDIS NJE GRUPI FSHATRASH
MBYET, PLYK, KRAPS, LALAR”.

Lidhur sot me date 19/04/2016 midis Bashkise Fier, perfaqesuar nga Kryetari z.Armando SUBASHI dhe “ALB-STAR” shpk Fier me NIPT J62903512W, perfaqesuar ne kete kontrate nga Administratori i saj z.Idajet Ismailaj te quajtur perkatesisht ketu e me poshte, Investitor dhe Sipermarres.

I. OBJEKTI I KONTRATES SHTESE

Punimet Shtese ne objektin “Rikonstrukcion i rruges lidhese midis nje grupi fshatrash Mbyet, Plyk, Kraps, Lalar”, sipas Preventivit te miratuar me zera e volume dhe specifikimeve teknike te pranuar ne prokurimin me procedure “Procedure me negociim, pa shpallje paraprake te njoftimit” te cilat jane pjese perberese e kesaj kontrate shtese dhe perbejne detyrim ligjor per zbatim nga palet ne kete kontrate.

II. VLEFTA DHE KUSHTET E KONTRATES SHTESE

Vlefte e negociuar ne prokurimin me procedure “Procedure me negociim, pa shpallje paraprake te njoftimit” per perfundimin e punimeve shtese, eshte 24 000 000 (njezete e kater milione) Leke me Tvsh.

Kontraktori “ALB-STAR” Shpk merr persiper dhe bie dakort qe te kryeje te gjitha zerat dhe volumet e punimeve sipas preventivit te miratuar shtese dhe te negociuar ndermjet paleve.

Ne vleften totale te mesiperme perfshihet TVSH si dhe te gjitha detyrimet e tjera fiskale ne Republiken e Shqiperise.

III. AFATI I KRYERJES SE PUNIMEVE SHTESE

Afati per kryerjen e punimeve shtese eshte **90 dite** nga lidhja e kesaj kontrate shtese.

IV. TE DREJTAT DHE DETYRAT E AUTORITETIT KONTRAKTOR

1. Te miratoje Situacionin Perfundimtar te punimeve shtese te paraqitur e te miratuar nga Mbikqyresi.
2. Te asistoj ne procesin e kolaudimit perfundimtar te Objektit.
3. Te marre ne dorezim Objektin pas kolaudimit perfundimtar.
4. Te veri ne shfrytezim Objektin dhe pas perfundimit te Afatit te Garancise te leshoje Certifikaten e garancise se punimeve.
5. Te Verifikoje kryerjen e riparimit te difekteve te ndodhura dhe per ato qe nuk jane eliminuar llogarit koston e ndreqjes se tyre dhe ben ndalesen nga vlefte e Garancise se Punimeve.



V.TE DREJTAT DHE DETYRAT E KONTRAKTORIT (SIPERMARRESIT)

1. Te siguroje Kontraten ne vleren **10%** te vlefes totale te kontrates shtese para lidhjes se saj. Sigurimi i Kontrates te behet ne formen e Garancise Bankare ose Siguracion ne nje nga shoqerite e sigurimeve te licensuara.
2. Te perfundoje punimet ne perputhje me volumet e punes per cdo ze te preventivuar per jo me shume se **90 dite**.
3. Te paraqese tek AK per miratim dhe per te realizuar likuidimin e punimeve, Situacion Perfundimtar per punimet e kryera dhe te jete i miratuar edhe nga Mbikqyresi i Punimeve.
4. Te njoftoje me shkrim AK per daten e perfundimit te punimeve dhe kerkesen per kolaudimin dhe marrjen ne dorezim te Objektivit. Ky njoftim duhet te behet jo me vone se **5 (pese) dite** para dates se perfundimit te punimeve.
5. Defektet e konstatuara gjate procesit te kolaudimit dokumentohen dhe nga kolaudatori lihen detyra dhe afate me shkrim per ndreqjen e tyre, keto kosto do te perballohen nga Kontraktori.
6. Kontraktori mban pergjegjesi dhe perballon rreziqet per demtimin dhe humbjen e materjaleve dhe prones publike e private te te treteve, plagosjen, demtimin apo vdekjen e punonjesve te tij apo personave te trete nga mosrespektimi i rregullave te sigurimit teknik etj. Kontraktori mban pergjegjesi per zbatimin e akteve ligjore e nenligjore ne fushen e ndertimeve.
7. T'i paraqese Mbikqyresit te Punimeve dhe Kolaudatorit te gjithe dokumentacionin shkresor te perditësuar dhe perfundimtar, si dhe certifikatat e provave te perdorura ne Objekt, te cilet mbas verifikimit dhe pranimit i administrojne ne dosjen e Objektivit.

VI.DISPOZITA TE TJERA

Pjese perberese e kesaj kontrate shtese eshte edhe procesverbali i dites se negociimit, me cmimet e negociuara e te pranuar sipas preventivave per punimet shtese, te detyrueshme per zbatim nga palet.

Kjo kontrate shtese hartohet ne 6 kopje, 1 per Sipermarresin, 1 per Mbikqyresin e punimeve dhe 4 per Bashkine Fier dhe pasi lexohet nga palet, nenshkruhet prej tyre me vullnet te lire ne Fier sot me date **19/04/2016**.

Për dhe në emër të :

AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA FIER

Armando SUBASHI
KRYETAR I BASHKISË



Për dhe në emër të :

KONTRAKTORI
"ALB-STAR" shpk

Idajet ISMAILAJ
ADMINISTRATOR I SHOQERISE

